



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “EVEREST” shpk
Adresa: Kamëz, Fabrika në Rrugën Nacionale, pranë nyjës së Betonit
TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: **“Rehabilitimi i fasadave në godinat publike” rruga e Dibrës.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi i fasadave në godinat publike” rruga e Dibrës**, duke realizuar, punimet për rehabilitimin e fasadave në godinat publike, në rrugën e Dibrës, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit

Fondi limit: **24.540.684,8** (njëzetë e katër milion e pesëqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër presje tetë) **lekë pa TVSH**

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit Nr.58 datë 30.12.2015, për miratimin e programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën me nr. 103/1 prot datë 21.01.2016 detajuar me urdhërin e kryetarit nr.10026, datë 01.04.2016 për “Detajimin dhe rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda programit të Shërbimeve Publike, Programit të menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, Programit të Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit, Programit të Turizmit dhe Kulturës, Programit të Srehimit dhe Planifikimit të Territorit dhe programit të Planifikimit, menaxhim Adiministrim për Vitin 2016”, rialokuar me VKB nr.84 datë 29.12.2016, për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2017”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **datë 23.01.2017 , ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike datë 30.12.2016**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ÇAUSHI” shpk
Vlera e ofertës pa TVSH = 0 (zero) lekë.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SIRETA – 2F.” shpk & “BELADI” shpk me nr. NUIS K51501008 J & J 62903254 C

Vlera e ofertës pa TVSH = **22.222.222** (njëzet e dymilion e dyqind e njëzet e dy mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë

3. Operatori Ekonomik “EVEREST” shpk me nr. NUIS J 78311921 L

Vlera e ofertës pa TVSH = **23.579.430** (njëzet e tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “ÇAUSHI” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Operatori Ekonomik “ÇAUSHI” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 10, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Çaushi” Sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 10, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SIRETA – 2F” shpk & “BELADI” shpk me nr. NUIS K51501008 J & J 62903254 C

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe

dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Bashkim Operatorësh ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Autoriteti kontraktor në dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik ka kërkuar në pikën 3 si më poshtë cituar:

3. Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve (**me eksperience pune mbi 15 vite**) në objekt te perfs hire ne licensen e shoqerise dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- i. Libreze pune (perkatese)
- ii. CV perkatese
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatese)
- iv. Diplome

Operatori Ekonomik “SIRETA 2 F” shpk ka deklaruar si drejtues teknik Znj. Marsela Lila e cila ka eksperiencë pune 12 vite, ky fakt është provuar nga AK me anë të CV dhe Librezës së Punës si dhe Diplomës së Znj. Marsela Lila.

Operatori ekonomik “BELADI” shpk ka deklaruar si drejtues teknik Z. Erald Muka I cili rezulton në bazë të CV dhe Diplomës se ka eksperiencë pune 7 vjet.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar për përmbushjen e kontratës së mësipërme që drejtuesi teknik të ketë një eksperiencë në punë minimalisht 15 vjet.

Ky kusht nuk është përmbushur nga bashkimi I shoqërive “SIRETA 2F shpk dhe BELADI” shpk

Në këtë mënyrë dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi I shoqërisë është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik pika 3.

Gjithashtu në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 5.1 citohet

Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesa (per gjashtë muajt e fundit) te pakten 7 punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT të vlefshme, ku nga keta te jene te pakten:

-2 punonjes (saldator) me kategori IV

- 1 punonjes (hidraulik) me kategori IV

-2 punonjës (murator) me kategori IV

-2 punonjës (pllakashtrues) me kategori IV

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik)

Te identifikuar ne list pagese sipas kodeve te sigurimeve shoqerore.

Shoqëria “SIRETA 2F” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik punonjës janë të paisur me IQT si më poshtë:

2 punonjës plakashtrues dhe përkatësisht Z. Gazmir Pali I cili ka kategorinë II dhe jo IV sic është kërkuar nga AK si dhe jo të vlefshme pasi ka skaduar më datën 14.10.2016, Z. Halil Skana me kategori II dhe jo kategori IV sic dhe është kërkuar nga AK

2 punonjës saldator dhe përkatësisht Z. Idriz Loga I cili ka kategorinë II dhe jo IV sic është kërkuar nga AK, Z. Shpëtim Gjyzeli me kategori II dhe jo kategori IV sic dhe është kërkuar nga AK

2 punonjës murator dhe përkatësisht Z. Qani Mere Peza I cili ka kategorinë I dhe jo IV sic është kërkuar nga AK, Z. Kujtim Doda me kategori I dhe jo kategori IV sic dhe është kërkuar nga AK si dhe jo të vlefshme pasi ka skaduar më datën 14.10.2016

2 punonjës hidraulik dhe përkatësisht Z. Mehmet Troci I cili ka kategorinë I dhe jo IV sic është kërkuar nga AK si dhe jo të vlefshme pasi ka skaduar më datën 14.10.2016, Z. Endrit Huli me kategori I dhe jo kategori IV sic dhe është kërkuar nga AK si dhe jo të vlefshme pasi ka skaduar më datën 14.10.2016

Shoqëria “BELADI” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik punonjës janë të paisur me IQT si më poshtë:

2 punonjës hidraulik dhe përkatësisht Z. Amarildo Popa I cili ka kategorinë II dhe jo IV sic është kërkuar nga AK, Z. Gresildo Çako me kategori II dhe jo kategori IV sic dhe është kërkuar nga AK .

Për sa më sipër asnjë nga punonjësit e paraqitur nga bashkimi I mësipërm nuk e përmbush kushtin e vendosur nga AK.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë “SIRETA 2F” shpk dhe “BELADI” shpk është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik në pikën 5.1

Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 5.2 citohet:

5.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen ***Urdhër mjeku***, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e vlefshme për periudhën e ndërtimit dhe te figurojnë ne list pagesa te paktën per ***6 (gjashhtë) muajt e fundit***. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje.

Shoqëria “BELADI” shpk ka paraqitur si mjeke të shoqërisë Znj. Aida Agolli për të cilën nuk ka paraqitur Urdhër Mjeku si dhe nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për 3 muaj konkretish Qershor, Korrik, Nëntor

Sa më sipër bashkimi I shoqërive nuk ka përmbushur kriterin e vendosur nga AK në lidhje me pikën 5.2, për rrjedhojë do të konsiderohet I pavlefshëm.

Në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 4.2 citohet:

Një punësim mesatar i të paktën 50 (pesëdhjetë) personave, për periudhën Nëntor 2015 - Nëntor 2016 të vërtetuar me;

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Nëntor 2015 - nëntor 2016 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Shoqëria “BELADI” shpk nuk ka paraqitur në sistem listpagesën për muajin Nëntor duke mospërbushur në këtë mënyrë kriterin e vendosur nga Ak për më saktë pikën 4.2, për rrjedhojë dokumentacioni i shoqërisë do të konsiderohet i pavlefshëm në lidhje me pikën e mësipërme.

Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit në pikën 11 kërkon gjithashtu:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona Vetshkarkues (Kapaciteti mbajtës minimumi 5 ton per secilin)	2 copë	
Minieskavator 2.5 – 4 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Automjet me vinc me kosh (per punime ne lartesi deri në 25 metra)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine (1-3 ton secila) kapaciteti mbajtës për secilën kamioncinë	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje per nivelim betoni (helikopter)	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela	7000 m2	Pronësi ose me qera
Rrjeta mbrojtese	7000 m2	Pronësi ose me qera
Aparat saldimi	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Operatori ekonomik "SIRETA 2F" në shtojcën 9 "Mbi disponimin e makinerive" ka deklaruar se zotëron minieskavator.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar të vihen në dispozicion një mini eskavator **2.5-4 ton** për ekzekutimin e kontratës. Minieskavatori I vënë në dispozicion nga operatori ekonomik ka kapacitet mbajtës **1.4 ton**. Operatori ekonomik "Beladi" shpk nuk ka paraqitur në shtojcën 9 minieskavator.

Për sa më sipër Bashkimi I shoqërive të mësipërme nuk e ka përmbushur pikën 11 të dokumentave Standarte të Tenderit /Kriteret e Veçanta.

Operatori ekonomik "SIRETA 2F" në shtojcën 9 "Mbi disponimin e makinerive" ka deklaruar se zotëron automjet vinç me kosh me targë AA397CL. Operatori ekonomik "SIRETA 2 F" më datën 16.01.2017 ka lidhur kontratën e sipërmarjes me object "Riokonstruksion I Kopshtit 55" me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë kun ë shtojcën 9 të deklaruar për objektin e mësipërm ka vendosur në dispozicion automjetin vinc me kosh me targë AA397CL.

AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në pikën 11 gërma f është shprehur si më poshtë cituar

Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Për sa më sipër Operatori Ekonomik "Sireta 2- F" shpk, nuk disponon mjet vinç me kosh për të përmbushur kontratën.

Operatori Ekonomik "Beladi" shpk ka deklaruar në shtojcën 9, kamion vinç me kosh me targë AA306KZ për të cilin nuk ka paraqitur foto siç edhe kërkohet në pikën 11 gërma d
Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për rrjedhojë operatori dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria e mësipërme është i paplotë .

Operatori ekonomik "SIRETA 2F" shpk në shtojcën 9 "Mbi disponimin e makinerive" ka deklaruar se zotëron 2 kamionçina.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës secila nga (**1-3 ton**) për ekzekutimin e kontratës. Kamionçinat e vëna në dispozicion nga operatori ekonomik kanë secila prej tyre kapacitet mbajtës mbi **3 ton**

Operatori ekonomik “Beladi” shpk ka deklaruar në shtojcën 9, 2 kamionçina përkatësisht me targë AA893 GP kapaciteti mbajtës i së cilës është poshtë 1 ton si dhe për të cilën nuk ka paraqitur foto, si dhe kamionçinë me targë EL0366B për të cilën nuk ka paraqitur foto.

Për sa më sipër dokumentacioni i paraqitur për mjetet e mësipërme nga bashkimi i shoqërive është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë: “SIRETA 2F” shpk dhe “BELADI” shpk lidhur me shtojcën 9 , me pikën 11 është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Është kualifikuar si ofertë e suksesshme, ky ofertues :

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “EVEREST” shpk, kualifikohet në vend të parë.

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **23.579.430** (njëzet e tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë) **lekë**. Çmimi total i ofertës me TVSH = **28.295.315** (njëzet e tetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e treqind e pesëmbëdhjetë) **lekë**. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 5 (pesë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.01.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “EVEREST” shpk, me adresë:** Adresa: Kamëz, Fabrika në Rrugën Nacionale, pranë nyjës së Betonit, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH **23.579.430** (njëzet e tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tridhjetë) **lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

